



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 17 prill 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i programit të punës së komisionit për datat 13-31 maj 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin".
4. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për shërbimet ajrore".

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Reme Lala, Ditmir Bushati, Ervin Bushati, Elona Hoxha, Ligoraq Karamelo, Eljo Hyskaj, Andrea Marto, Adnor Shameti, Eglandina Gjermani, Rudina Hajdari, Evis Kushi, Vasil Sterjovski dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Vasilika Hysi dhe Alket Hyseni.

Të ftuar:

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Doriana Toro – Specialiste e Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Krislen Keri – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Lilika Radovicka – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, u uroj mirëseardhjen anëtarëve të rinj të komisionit: zotit Ralf Gjoni, i cili është njëherazi edhe nënkryetar, si dhe zotit Vasil Sterjovski, anëtar.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit të datës 17 prill 2019, e cila më tregon se kemi ditë pa u mbledhur dhe se na paska marrë malli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Kallojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin dhe miratimin e programit të punës së komisionit për datat 13-31 maj 2019.

Siç jeni në dijeni, sot dhe nesër do të shqyrtojmë respektivisht dy projektligje, që kanë të bëjnë me ratifikim marrëveshjes, por për të cilat ne jemi komision për dhënie mendimi.

Në pritje të përfaqësuesve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, mendoj të vijojmë me diskutimin e projektligjit të dytë në rendin e ditës "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për shërbimet ajrore".

Prezentë kemi zotin Shkreli, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Keri, drejtor i Përgjithshëm, si dhe zonjën Radovicka, përgjegjëse Sektori në të njëjtën ministri.

Mirë se vini!

Përpara se t'ia jap fjalën zotit Shkreli, i uroj mirëseardhjen edhe zotit Eljo Hyskaj, i cili është anëtar zëvendësues i këtij komisioni.

Mirë se vini, zoti Hyskaj, dhe punë të mbarë!

Zoti Shkreli, fjala është për ju.

Ju lutem, shkurtimisht, lidhur me projektligjin.

Artan Shkreli – Mirëdita dhe faleminderit për ndryshimin e rendit të ditës!

Jemi para jush sot për shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së

Arabisë Saudite për shërbimet ajrore", e cila, në thelb, është një marrëveshje rutinë, në raport me marrëveshjet që kryhen me vende të tilla, ndërkohë që me Arabinë Saudite është hera e parë që lidhet një e tillë, por në këndvështrimin e pikave dhe përmbajtjes së marrëveshjes, nuk kemi të bëjmë me një risi, sepse është njësoj si marrëveshjet e tjera të lidhura me vendet reciproke.

Kjo marrëveshje bëhet në vazhden e vizitës, që zhvilloi kryetari i Këshillit të Ministrave në Arabinë Saudite kohët e fundit dhe të procesit të liberalizimit të vizave ndërmjet dy vendeve, e cila mundëson lëvizjen e lirë qoftë të shtetasve të Arabisë Saudite në Shqipëri, qoftë anasjelltas.

Marrëveshja parashikon disa rregulla, të cilat po i përmend shkurtimisht, pasi, siç e thashë, nuk ndryshon nga marrëveshjet e tjera kuadër: për zhvillimin e koordinuar dhe liberalizimin progresiv të transportit ndërmjet palëve dhe që, natyrisht, mbështetet në nevojat reciproke, të cilat më vonë do të specifikohen në aktet dhe kontratat dypalëshe, pasi, natyrisht, çdo vend ka specifikat e tij edhe për sa i përket transportit ajror, gjithashtu, u jepen të drejtat reciproke të dyja vendeve, duke u mbështetur mbi të dhënat e shërbimeve ajrore ndërkombëtare, për përcaktimin e autorizimeve të përshtatshme për operim, si dhe njohjen e ndërsjellë të certifikatave dhe të licencave, një pjesë e të cilave do të njihen automatikisht, ndërkohë që një pjesë tjetër do të konvertohen mbi bazën e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve dypalëshe.

Gjithashtu, lidhur me detyrimin e palëve për mbrojtjen e sigurisë së aviacionit civil ndaj akteve dhe ndërhyrjeve të paligjshme, këtu u referohem qoftë kodeve reciproke ajrore, qoftë kodeve të tjera, të cilët nuk kanë të bëjnë, po themi, me marrëveshjet e aviacioneve civile të të dyja palëve, por hyjnë edhe kode të tjera, që kanë të bëjnë me Ministrinë e Brendshme, aktet kundër terrorizmit e të tjera (këta janë kapituj të veçantë që nuk preken këtu), si dhe me sigurimin e palëve në lidhje me garantimin e zbatueshmërisë së legjislacionit vendas gjatë qëndrimit në territorin përkatës. Edhe ky aspekt hyn në kuadrin e një marrëveshjeje, po themi, kuadër dhe rutinë, sikurse me të gjitha vendet e tjera, por kuptohet që për vende me specifika shumë të ndryshme është e rëndësishme marrja parasysh e respektimit të legjislacionit përkatës të vendeve të veçanta për periudhat e qëndrimit brenda territorit respektiv, sidomos jashtë territorit aeroportual, që është deri diku ndërkombëtar.

Këto janë aspektet kryesore ku mbështetet projektligji ose, më mirë të themi, ky ratifikim marrëveshjeje, se projektligji ratifikon këtë. Kështu që, në qoftë se një relator ose

anëtar i komisionit dëshiron të shtojë diçka ose të bëjë pyetje, ne jemi të hapur t'u përgjigjemi.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shkreli!

Fjalën e ka zonja Kushi, në cilësinë e relatores.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë do të përpiqem që ta prezantoj relacionin përmbledhtazi, meqenëse zoti Shkreli i dha detajet më të rëndësishme të këtij projektligji. Qëllimi i tij është ratifikimi i marrëveshjes për shërbimet ajrore ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Shqipëria është palë në Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar ose, siç njihet ndryshe, Konventa e Çikagos, çka nënkupton se mbart edhe detyrimin që vjen nga kjo konventë për koordinimin e veprimtarisë në fushën e aviacionit civil, si dhe bashkëpunimin në fushën e transportit ajror.

Ratifikimi i marrëveshjes synon krijimin e kushteve lehtësuese, nëpërmjet të cilave do të bëhet e mundur lëvizja pa pengesa për shtetasit e të dyja vendeve, por do të rritet edhe bashkëpunimi ndërmjet të dyja palëve.

Kjo marrëveshje vendos rregullat bazë ose parimet bazë përtej të cilave do të drejtohet ky bashkëpunim dhe nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit. Vlen të theksohet ky detaj, pra se nuk ka efekte financiare, ndërsa për sa i takon përjashtimit nga detyrimet doganore ose nga detyrimet e tjera, secila palë (është përcaktuar në marrëveshje) do të caktojë një linjë ajrore të palës tjetër për ta përjashtuar në mënyrë të plotë, sipas legjislacionit përkatës, nga detyrimet doganore ose ato tatimore.

Unë vlerësoj që kjo marrëveshje do të forcojë bashkëpunimin ndërmjet të dyja vendeve në fushën e transportit ajror, ndaj u sugjeroj kolegëve që ta votojnë projektligjin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegja Kushi!

Kalojmë te pyetjet nga kolegët.

Kush e do fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Shkreli, ju ndoqa me shumë vëmendje, por nuk arrita ta kuptoj efektin në praktikë të kësaj marrëveshjeje.

(Zoti Shkreli ndërhyr pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Po, zoti Shkreli.

(Deputeti Bushati ndërhyr pa mikrofon.)

Ditmir Bushati – ...për udhëtarët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë!

Atëherë, kjo është një marrëveshje që lidhet për herë të parë ndërmjet të dyja vendeve, pra nuk ekziston një marrëveshje paraardhëse, nuk është një vazhdim apo një ratifikim, i cili, po themi, rinovon një marrëveshje ekzistuese. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje mundësohet operimi ndërmjet të dyja vendeve në fushën e aviacionit civil. Ky është thelbi i marrëveshjes, çka nënkupton se pa këtë marrëveshje, ky operim (i cili nuk ekziston) nuk mund të bëhet, nuk mund të hyjë në fuqi. Pra, marrëveshja i hap rrugë këtij operimi dhe, sikurse e theksova edhe më parë, është vazhdimi i një lehtësimi progresiv për lëvizjet e shtetasve pa viza në këto dy vende.

Kohët e fundit ka një interes të shtuar të Arabisë Saudite në raport me Shqipërinë. Ndoshta duhet thënë se, në njëfarë mënyre, kjo marrëveshje u pat shtyrë një herë, po bëhet tani dhe, kështu, fillon marrëdhënia ndërmjet dy aviacioneve civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa këtë marrëveshje, nuk operon dot asnjë linjë ajrore e Arabisë Saudite në territorin tonë dhe anasjelltas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – E doni fjalën për pyetje, zonja Hajdari?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, fjalën e ka fillimisht zonja Hajdari për pyetje, pastaj zoti Bushati për një koment.

Rudina Hajdari – Edhe unë kam një pyetje në lidhje me atë çfarë tha zoti Bushati. Në këndvështrimin e politikës së jashtme të Shqipërisë, çfarë interesi kemi ne me një shtet si Mbretëria e Arabisë Saudite, në një kohë kur Arabia Saudite është një vend problematik, duke pasur parasysh ngjarjet e fundit që ndodhën në nëntor (u akuzua mbreti i Arabisë Saudite për vrasjen e një gazetari) dhe se partneri ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të

Amerikës, kanë vënë diku te 17 sanksione kundër disa prej anëtarëve të qeverisë së këtij vendi?

Pra, nga këndvështrimi i politikës së jashtme, pse Shqipëria, si anëtare e NATO-s, duhet të ketë një marrëdhënie kaq të afërt me Arabinë Saudite? Ç'është ky interes, siç ju po e përshkruani, me Arabinë Saudite?

Mimi Kodheli – Zoti Bushati, kishit një koment për të bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Ne jemi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nuk hyjmë dot, po themi, nuk është në tagrin tonë të interpretojmë marrëdhëniet bilaterale edhe në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është ajo që mund të japë përgjigje më të saktë, e them me modesti këtë, përveç opinionit tim personal, i cili nuk besoj se u intereson njerëzve.

Interesi në rritje nga Arabia Saudite, për të cilin unë fola, është i natyrës turistike dhe ka të bëjë me vendosjen e një raporti ekzistues tashmë ndërmjet të dyja vendeve. Pra, nuk është se ne nuk kemi raporte, thjesht këtë raport e adresojmë edhe në fushën e aviacionit civil. Domethënë, kjo nuk është një marrëveshje që i rrit politikisht marrëdhëniet ndërmjet të dyja vendeve. Ne nuk futemi në atë sferë në këtë rast. Kjo është përgjigjja që mund të jap për pjesën time.

Lidhur me marrëdhëniet që ata vetë kanë me demokracinë e të tjerë, nuk jam në gjendje të jap një përgjigje.

Mimi Kodheli – Po, zoti Bushati.

Ditmir Bushati – Kam thjesht një koment ose sugjerim. Në rast se kjo marrëveshje synon të hedhë bazat për sa i përket bashkëpunimit në fushën e aviacionit civil, siç u tha këtu nga zëvendësministri, ndërmjet Shqipërisë dhe Arabisë Saudite, kjo është një gjë, prandaj unë pyeta në lidhje me efektet në praktikë, sepse zakonisht, kur shkohet drejt marrëveshjeve të tilla, ka një plan paraprak, ka edhe një parashikueshmëri se cilat linjat mund të operojnë, cili mund të jetë numri i udhëtarëve, çfarë parashikon marrëveshja nga pikëpamja e lehtësirave dhe çfarë pune konkrete duhet të bëjnë autoritetet e të dyja vendeve.

Për sa i përket regjimit të vizave, bie dakord katërcipërisht me përgjigjen që ju dhatë në drejtim të deputetes Hajdari, që kjo çështje nuk ka lidhje me këtë marrëveshje. Por Shqipëria ka një kontratë me Bashkimin European, të lidhur në vitin 2010, në bazë të së cilës ka vende që janë në listën e bardhë të Shengenit, ka edhe vende që janë në listën e zezë të

Shengenit, dhe Shqipëria i përmbahet vetëm kësaj kontrate. Ndaj dëshiroj që këto dy çështje të mos i ngatërrojmë me njëra-tjetrën, aq më tepër në një kontekst të trazuar ku ndodhet sot për sot ky proces i liberalizimit të vizave në Europë.

Prandaj edhe e shtrova pyetjen nga pikëpamja e efekteve praktike. E them këtë, sepse ka vende të tjera të Gjirit Persik, të cilat operojnë në mënyrë të zhdërvjellët në linjat e tyre ajrore, sidomos me Serbinë, me Malin e Zi, si dhe me Maqedoninë e Veriut. Mendova që ndoshta aviacioni civil ka disa statistika dhe na krijon një perspektivë se ku mund të jemi me këtë marrëveshje në 1-15 vjetët e ardhshëm.

Meqë ju iu referuat industrisë së turizmit, nuk do të ishte aspak e ekzagjeruar që këtu të kishte edhe përfaqësues të Ministrisë për Turizmin apo të enteve promovuese në këtë fushë për të na bërë një analizë edhe në lidhje me avantazhet krahasuese, pse Arabia Saudite dhe jo Emiratet e Bashkuara Arabe; pse kjo e dyta dhe jo Kuvajti; pse Kuvajti dhe jo Bahrejni e kështu me radhë, duke u bazuar me analizat që duhet të ketë aviacioni civil për këtë çështje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Unë mendoj se projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore" i rri mirë shtimit të lëvizjes qoftë kjo për arsye personale, turistike, qoftë për arsye ekonomike dhe, sigurisht një lehtësimi fiskal që lidhet padyshim, edhe me nivelin e lartë të çmimit të biletave që përballojnë qytetarët shqiptarë për shkaqe që tashmë i dimë, për qarkullimin për arsye personale apo për arsye biznesi, kështu që jam dakord me komentin e zotit Bushati lidhur me një prezantim të bazuar në një studim më të hollësishëm për arsyet pse Riadi dhe jo Doha, apo Dubai.

Mendoj se pavarësisht kësaj, ne ta kalojmë këtë projekt marrëveshje me shpresën që do të vijmë të tilla edhe më tutje, sepse duke iu përmbajtur të gjitha ratifikimeve të të gjitha marrëveshjeve në të cilat aderon Shqipëria, kjo do të jetë vetëm një vlerë e shtuar dhe jo një pengesë.

Nëse nuk ka komente të tjera, unë mendoj ta votojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, para se ta kalojmë në votim ka kolegja Hajdari një pyetje të fundit.

Rudina Hajdari – Kisha edhe një pyetje të fundit: A ka ndonjë vend në rajon një marrëveshje të tillë përveç Shqipërisë?

Artan Shkreli – Po jap dy përgjigje për pyetjen.

E para, ekzistojnë marrëveshje edhe me vende të tjera të rajonit arabik. Nuk është e vetme marrëveshja me Arabinë Saudite, por ka marrëveshje edhe me vendet e tjera rrotull. Në vijim të asaj që tha edhe zoti Bushati, për pyetjen direkte të zonjës Hajdari, vendet rrotull nesh kanë marrëveshje të tilla dhe unë mendoj se është vetëm Shqipëria nga vendet e Ballkanit Perëndimor, që nuk ka një marrëveshje të tillë me Arabinë Saudite.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Mendoj ta kalojmë në votim. Kush është dakord në parim me ratifikimin e marrëveshjes?

Kundër? Një votë kundër. Të shënohet në procesverbal!

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord?

Kundër? Një votë kundër.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord?

Kundër? Një votë kundër.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord?

Kundër? Një votë kundër.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Falënderoj zotin Shkreli dhe stafin për prezencën në komision!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2019, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin"

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Reme Lala, Ditmir Bushati, Ervin Bushati, Elona Hoxha, Ligoraq Karamelo, Eljo Hyskaj, Andrea Marto, Adnor Shameti, Eglantina Gjermeni, Rudina Hajdari, Evis Kushi, Vasil Sterjovski dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Vasilika Hysi dhe Alket Hyseni.

Të ftuar:

Nikolla Lera – Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Doriana Toro – Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Mimi Kodheli – Kalojmë në shqyrtimin e marrëveshjes së dytë.

Mirë se vini zoti Lera dhe zonja Toro! Që të dy janë përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

Kam komunikuar para pak minutash me ministren e Ekonomisë dhe të Financave. Unë e di që ju nesër do të jeni prezent në diskutimin e dy projekt marrëveshjeve të tjera. Minimalisht, duhet të jetë prezent në komision njëri nga zëvendësministrat e Ekonomisë dhe të Financave. Në të kundërt, komisioni nesër nuk do të mbledhet. Këtë ia kam transmetuar edhe ministres dhe po e transmetoj tani edhe për efekt të regjistrimit.

Përveç respektit që kam si shok i vjetër i shkollës, kjo tryezë meriton të ketë në mbrojtje të çdo projektligji që vjen këtu, gjithmonë në nivel zëvendësministri e lart. Unë nuk pretendoj të vijë ministri vetë, sepse e di që ka axhendë të ngarkuar.

Pra, sot do të shqyrtojmë projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin".

Zoti Lera, fjala për ju për të thënë 2 fjalë shteruese për këtë projektligj!

Nikolla Lera – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe një herë, ju kërkoj ndjesë për nivelin e pjesëmarrjes, por zëvendësministri që mbulon këto funksione, është së bashku me ministren Denaj me shërbim jashtë Shqipërisë. Ai nesër do të kthehet.

Mimi Kodheli – Shumë bukur!

Jam e bindur që ju keni një axhendë të ngarkuar, por ne mund ta kishim shtyrë për një ditë tjetër. Ne në përgjithësi, jemi këtu çdo ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Lera!

Nikolla Lera - Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë është në kuadër të marrëveshjeve që Shqipëria ka me 42 vende të botës. Dihet që këto lloj marrëveshjesh për shmangien e tatimit të dyfishtë shërbejnë si pararendës për investimet reciproke të dy vendeve, të cilët lidhin marrëveshjen. Ajo adreson taksimin e individëve dhe të personave rezidentë, në mënyrë që ta shmangë taksimin e dyfishtë, sepse në kushtet e tatimit të dyfishtë asnjë nuk do ta paguajë tatimin edhe në vendin e rezidencës, edhe në vendin e burimit.

Pra, marrëveshja në fjalë është në linjën e të gjitha marrëveshjeve, që ne kemi filluar të nënshkruajmë me vendet e tjera që nga viti 1992. Natyrisht, investimet nga vendet e pasura të rajonit, shihen me interes për vendin tonë. Ne kemi nënshkruar marrëveshje jo vetëm me Arabinë Saudite, por edhe me disa vende të tjera të pasura të këtij rajoni dhe, siç thashë, këto marrëveshje janë pararendës të fluksit të investimeve reciproke që mund të vijnë në vendin tonë. Ato sigurojnë garanci për investitorët që të ardhurat e tyre do të taksohen vetëm në një vend.

Natyrisht, marrëveshja është bazuar në modelin tonë të marrëveshjeve, që synon të mbrojë të ardhurat, bazën tatimore në Shqipëri, duke pasur parasysh që ne jemi një vend burimi, nuk jemi një vend rezidence, që do të thotë se presim më shumë investime në krahasim me investimet që personat juridikë shqiptarë mund të kryejnë në vendet e tjera. Duke qenë një vend burimi, kemi synuar që me këtë marrëveshje të mbrojmë interesin kombëtar nëpërmjet taksimit në Shqipëri të asaj pjese, që duhet të mbetet në Shqipëri. Siç e thashë kjo është në kuadër të strategjisë që ne kemi ndjekur me të gjitha marrëveshjet për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Natyrisht, aty ku palat nuk bien dakord, do të ketë negociata për të gjetur rrugën më të mirë për të negociuar marrëveshjen, sikurse është vepruar me të gjitha marrëveshjet. Kjo marrëveshje është negociuar shumë herët, besoj në periudhën 2009-2010, është miratuar me VKM në vitin 2012 dhe tashmë me rastin e vizitës së ministres Denaj në Arabinë Saudite, u nënshkrua dhe do të kalojë për ratifikim në Kuvend.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Lera!

Isha më se e bindur se ju do ta shpjegoni denjësisht këtë, sepse jeni absolutisht në fushën tuaj të ekspertizës, më shumë se çdo zëvendësministër (me gjithë respektin që kam për zëvendësministrat).

Fjala për ju zoti Bushati, si relator i komisionit!

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetare!

Marrëveshja prek personat që janë rezidentë në një apo në dy shtete kontraktore, pra në Shqipëri apo në mbretërinë e Arabinë Saudite. Tatimet që përfshihen në këtë marrëveshje janë: tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi kapitalin. Të tilla tatime do të konsiderohen të gjitha tatimet të vendosura mbi të ardhurat e plota, mbi kapitalin ose mbi elementët e të ardhurave ose të kapitalit duke përfshirë: tatimin mbi fitimin nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme; tatimet mbi totalin e pagesave ose pagesat e bëra nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

Për Shqipërinë kjo marrëveshje do të shtrihet mbi këto tatime:

i. Tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimet mbi fitimin e shoqërive; tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave të kapitalit nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme;

ii. tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

iii. tatimi mbi pasurinë:

Në rastin e mbretërisë së Arabisë Saudite do të përfshijë këto tatime:

i. Zakati;

ii. tatimi mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin e investimit në gazin natyror;

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje zbatohen edhe për çdo tatim të njëjtë ose thelbësisht të ngjashëm, që do të vendoset pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes.

U propozoj kolegëve të votojnë pro kësaj marrëveshjeje.

Mimi Kodheli - Faleminderit, kolegu Bushati!

Kush ka pyetje apo diskutime?

Urdhëroni, zonja Hajdari për diskutim!

Rudina Hajdari – Kjo është marrëveshja e dytë e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite. Unë e deklaroj votën time kundër saj, se nuk më duket normale që ne të lidhim dy marrëveshje me mbretërinë e Arabisë Saudite. Sido që të jetë situata, mendoj se ky është një vend problematik dhe nuk është në interes të Shqipërisë për të pasur marrëdhënie të shtuara me Arabinë Saudite, duke marrë parasysh gjendjen e acaruar mes vendeve perëndimore dhe Arabisë Saudite, plus sanksioneve që i ka vënë bota perëndimore.

E mirëkuptoj zotin Bushati dhe ju kërkoj ndjesë, sepse nuk është në kuadër të pyetjeve, por është thjesht një diskutim!

Këto marrëveshje e dëmtojnë interesin e Shqipërisë, sepse neve nuk na duhen investime të tilla në Shqipëri. Nëse kemi dëshirë apo duam të shtojmë investimet e huaja, duhet të synojmë të lidhim marrëveshje me vende të tjera dhe jo me të tilla vende, të cilat bartin probleme dhe mund ta cenojnë interesin apo sigurinë e Shqipërisë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja Hajdari!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Unë mendoj ta hedhim në votim projekt marrëveshjen.

Kush është dakord në parim me ratifikimin e marrëveshjes? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me një votë kundër dhe asnjë abstenim projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Falënderoj zotërinjtë për prezencën!

Mbledhjen e mbyllim këtu.

MBYLLET MBLEDHJA